


Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës Arbënçsha Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Ud. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Erblin Hetemi, U. d. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë: 17.04.2024 VI-020-242
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Ahmetaj, Zyrtare për Monitorim të Komunave	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim	
Lloji i aktit:	Vendim i kuvendit të komunës së Gjakovës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullos (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim përfundimtar Nr. 01-011/01-4933 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale P-70705029-016371-1

I miratuar më datë: 28.03.2024

I parashtruar p. shqyrtim në MAPL më datë: 03.04.2024

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Gjakovës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2024, ka miratuar Vendimin përfundimtar Nr. 01-011/01-4933 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale P-70705029-016371-1.

MAPL, konstaton se vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës është në kundërshtim me Ligjin nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2022 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës:

Vendimi i miratuar është bazuar në nenin 19 paragrafi 3 ku i Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenet 21 dhe 22 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2022 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, të cilat sqarojnë procesin e vlerësimit të ofertave, ndërsa procedurat të cilat janë zhvilluar për këtë dhënie të pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë janë bërë sipas ankandit publik.

Andaj bazuar në të lartcekurat, Kuvendi i Komunës së Gjakovës duhet të ndërmerri veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin me legjislacionin në fuqi..

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbete në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

up

shmi

up

shmi



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E GJAKOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. /2024

Datë: 28.03.2024

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe nenin 21 dhe 22 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2022 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2024, pas diskutimit lidhur me pikën 7-të rendit të ditës: Rekomandimi i Komisionit Vlerësues për miratimin e vendimit përfundimtar për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të Pronës së paluajtshme Komunale me numër të parcelës P-70705029-016371-1, e miratoi këtë:

V E N D I M

Përfundimtar për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale.

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës miraton vendimin përfundimtar për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale me numër të parcelës P-70705029-016371-1, ofertuesit: D&T Group SH.P.K, OSMANI CONSTRUCTION SH.P.K dhe KAN GROUP SH.P.K të rekomanduar nga Komisioni Vlerësues si oferta me e favorshme .
2. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme Komunale të cekur në pikën e 1 të këtij Vendimi është në kohëzgjatje prej 99 (nëntëdhjetenëntë) viteve .
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të Pronës Komunale të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është siç përcaktohet në vendimin paraprak me numër 01-020-37472 të datës 25.07.2016, funksionalizimi i pronës, ndërtimi i objektit me destinim – objekt banimi shumë banesor me afarizëm.
4. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë: Rekomandimi dhe dokumentet tjera të Komisionit Vlerësues dhe oferta e përzgjedhur .
5. Autorizohet Kryetari i Komunës së Gjakovës që brenda 10 ditë pune nga hyrja në fuqi e këtij vendimi të lidhet kontrata me fituesin, me anë të së cilës përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese .
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
7. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini.
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë .
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
 - Arkivit .



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica - Municipality of Gjakova

ARKIVA DALËSE
IZLAZNE ARHIVE
OUTPUT ARCHIVES

Nr. Inv./Br. Inv. 01-463/02-4358
Data/Datum/Date 20.03.2024
Gjakovë - Djakovica - Gjakova



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data/nr	20.03.2024
Për:	Arbëneshja Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës
CC:	- Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës - Arkivit
Përmes:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Nga:	Durim Halilaj, Kryesues i Komisionit për Dhënien në Shfrytëzim afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale me numër të parcelës P-70705029-016371-1
Lënda:	REKOMANDIM

Të nderuar,

Komisioni Vlerësues (i themeluar me vendim të Kuvendit të Komunës së Gjakovës, me numër 01-011/01-21401 të datës 30.10.2023, në bazë të nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 21 dhe 22 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës si dhe Njoftimin Publik me numër 01-463/02-1251 të datës 29.01.2024, me datën 20.03.2024, nxjerr këtë:

REKOMANDIM

- Komisioni Vlerësues rekomandon Kuvendin e Komunës të miratojë vendimin përfundimtar për Dhënien në Shfrytëzim afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale, me numër të parcelës P-70705029-016371-1, ofertuesit: D&T Group SH.P.K, OSMANI CONSTRUCTION SH.P.K dhe KAN GROUP SH.P.K.
- Komisioni Vlerësues, pas vlersimit të ofertës së vetme, si dhe pas përfundimit të afatit të ankesave, oferta e përzgjedhur më e favorshme sipas kushteve të përcaktuara në Njoftimin Publik është: D&T Group SH.P.K, OSMANI CONSTRUCTION SH.P.K dhe KAN GROUP SH.P.K.

3. Pas miratimit të vendimit përfundimtar, të autorizohet Kryetari i Komunës që brenda dhjetë (10) ditë pune nga hyrja në fuqi e vendimit përfundimtar të lidhë kontratën me fituesin.
4. Pjesë përbërëse e këtij Rekomandimi është: Raporti i Vlerësimit dhe Oferta e përzgjedhur.

Me respekt!